



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 26 gusht 2014

Numri i lëndës: 2014-08

C.X.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 26 gusht 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 25 shkurt 2014. Ankuesi ka kërkuar që emri i tij/saj mos të bëhet publik.

II. FAKTET

2. Ankuesi pohon se që nga viti 1992, një psikiatër e kishte trajtuar atë *"në mënyrë të pandërgjegjshme, me mjete të sofistikuara, ku ai i lexon idetë në trurin tim dhe i publikon ato në mediat e Kosovës, si në televizion dhe radio"*.
3. Ankuesi thekson se ai ka paraqitur disa ankesa në EULEX-it, duke i kërkuar EULEX-it që ta zgjidh çështjen e tij. Ankuesi i ka paraqitur Panelit dy kopje të këtyre letrave, të datave 10 shtator 2011, si dhe 7 maj 2012.
4. Ankuesi gjithashtu i ka dorëzuar Panelit tri përgjigje nga EULEX-i. Në letrën e parë të datës 17 nëntor 2011, EULEX-i i referohet letrës së ankuesit të datës 10 shtator 2011, në të cilën ai kishte kërkuar që të rishqyrtohet vendimi i Prokurorit Publik Komunal. EULEX-i më tej kishte shpjeguar se nuk ishte në pozitë që t'i shqyrtoj vendimet e organeve të prokurorisë dhe gjyqësorit, të cilat do të mund të kundërshtohen vetëm përmes mjeteve juridike e ligjore.
5. Në një letër tjetër të datës 15 tetor 2012, zyra e shefit të stafit të EULEX-it iu ka referuar letrës së ankuesit të datës 8 tetor 2012, në të cilën ankuesi kishte kërkuar një takim me EULEX-in për të diskutuar problemet e tij të pazgjidhura. EULEX-i ka ftuar ankuesin që të paraqesë hollësitë e tjera në mënyrë që të jetë në gjendje të shqyrtoj çështjen, sepse ka gjetur se parashtrësit e ankuesit ishin të paqarta.
6. Në një tjetër letër nga EULEX-i, të datës 15 maj 2013, EULEX-i iu është referuar një letre prej ankuesit, të datës 7 maj 2013 dhe e ka ftuar përsëri që të ofroj të dhëna më të qarta dhe më të sakta, në mënyrë që EULEX-i të jetë në gjendje ta shqyrtoj lëndën.
7. Ankuesi ka paraqitur se në një datë të papërcaktuar ai ka kontaktuar me zyrën e Avokatit të Popullit, e cila nuk ka pranuar të veproj në bazë të kërkesës së tij.

III. ANKESAT

8. Ankuesi kërkon nga Paneli që të zgjidhen problemet që i ka në lidhje me psikiatrin e tij.

III. LIGJI

9. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për

Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

10. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
11. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
12. Paneli konsideron se pretendimet e parashtruara nga ankuesi janë të pabazuara. Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.
13. Paneli më tutje nuk gjen ndonjë tregues se EULEX-i ka qenë i përfshirë në ndonjë cilësi në çështjet rreth të cilave është bërë ankesë (po ashtu krahasoni [Shaip Gashi kundër EULEX-it](#), 2013-20, 25 nëntor 2013 në par. 9), e as nuk ka ndonjë dëshmi para Paneli që EULEX-i ka shkelur të drejtat e ankuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, konstaton se ankesa është e pabazuar në bazë të nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese